

FJALA E DEPUTETIT BLENDI KLOSI

E HËNË 23 MAJ 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, pak ndryshe nga kolegët e mi të maxhorancës, do të doja të falënderoja shumë edhe zonjën Zhupa, natyrisht, edhe zonjën Tabaku, në qoftë se do, që ta ketë gati dhe për replikë, sepse këtë vit, mbase dhe që nga koha kur ju dogjët mandatet, ky mund të jetë projektligji i parë për të cilin realisht ka një debat! Kështu që shumë mirë që u kthyet në jetën parlamentare. Për këtë dua të falënderoj zonjën Zhupa, se të paktën nga një debat i madh, që u hap në komisione, pastaj vazhdoi nëpër televizione e sot në parlament, brenda dhe jashtë tij, njerëzit do të marrin vesh disa të vërteta, të cilat, duke mos u diskutuar, do të vazhdonin të barteshin si shumë legjenda të tjera, që, fatkeqësisht, kur dëgjohen nga goja e deputetëve, besohen shumë, edhe pse janë krejtësisht të pavërteta.

Kështu që, duke falënderuar shumë stafet e të dyja ministrive, edhe të Ministrisë së Kulturës, edhe Ministrisë së Turizmit, që ofruan për të gjithë ne deputetët materialet e nevojshme, do të doja shkurtimisht t'u përgjigjesha disa të pavërtetave, të cilat u sqaruan nga ky diskutim! "A i jepet Butrinti një privati?". Të paktën ta themi shkurt: jo, Butrinti do të vazhdojë të jetë pronë e shtetit shqiptar. Qetësohuni! "A do të vazhdojë të administrohet Butrinti nga shteti?". Po, Butrinti do të vazhdojë të menaxhohet nga shteti shqiptar, në bashkëpunim me një fondacion shumë të rëndësishëm, i cili, shumë e mirë që e tha zonja Tabaku, është ndërtuar me paratë e USAID-it dhe vazhdon të mbështesë shtetin shqiptar për të ecur para në veprimtarinë e tij me shumë probleme.

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të jetë 100% shqiptar. Është themeluar nga Ministria e Kulturës, së bashku me Fondacionin Shqiptar për Zhvillim. Pra, qetësohuni edhe për këtë! Ministria, nëpërmjet një qendre monitorimi, do ta monitorojë këtë fondacion dhe aktivitetin e tij. Ministria e Kulturës është kryetare e këtij bordi. Pra, edhe për këtë duhet t'i qetësojmë njerëzit. Marrëveshja nuk është e përrjetshme, nuk është një koncesion afatgjatë, është vetëm një marrëveshje bashkëpunimi 10-vjeçare. Në këta 10 vjet ne do të bashkëpunojmë me një fondacion shumë prestigjioz, për t'i dhënë mundësi Butrintit jo vetëm të jetë një gjë e bukur atje, që ta vizitojmë ne, mbase edhe fëmijët tanë, por të jetë dhe një pikë fokale për të gjithë Mesdheun, ku të ketë mundësi që aty të prodhohen para, se është prodhuar histori, dhe kjo është shumë gjë e mirë, dhe të vizitohet nga sa më shumë njerëz.

Edhe për këtë, qetësohuni! Paratë që do të grumbullohen në Butrint do t'i përkasin vetëm Butrintit. Asnjë lek, asnjë euro, asnjë dollar, asnjë jen e asnjë para nuk do të dalë nga Butrinti. Paratë që do të grumbullohen, do të përdoren për të mirën e Butrintit, për ta zhvilluar atë, për ta bërë konkurrent, për të pasur mundësi vetëmenaxhimi më të mirë. Së bashku me Butrintin, gjë që nuk ka ndodhur deri tani, si sit i trashëgimisë kulturore, do të mbështetet e gjithë zona e mbrojtur e Butrintit, një zonë, e cila (pastaj do të flasim dhe për filozofinë e zonave të mbrojtura) nuk mund të jetë e shkëputur nga kjo bukuri e rrallë që ne kemi në sit, por edhe bukuria natyrore e të gjithë parkut do të mbështetet nga të ardhurat që janë grumbulluar dhe do të grumbullohen në vazhdim. Shpresojmë shumë që të shtohen e të shtohen...

Në fakt, edhe kjo që bëni ju ia shton vlerat Butrintit, se flasim më shumë për Butrintin, por kjo nuk ka asnjë rëndësi. Unë them shqyrr që po bëhet një opozitë reale për një çështje! Pra, këtu nuk kemi asnjë formë koncesioni. Fondacioni është jofitimprurës dhe të gjitha paratë shkojnë në Butrint. Asnjë lek nuk marrin anëtarët e bordit, se e kam dëgjuar këtë edhe publikisht në debat, edhe në komision. Anëtarët e bordit nuk janë njerëz të përveçëm, e nderuar mikja ime Ina, janë drejtorë të fondacionit. Është kjo ministre, nuk është kjo apo do të jetë një ministre tjetër nga maxhoranca dhe për 10 vjet, pas 10 vjetësh, mbase po erdhët ju, do të jetë një nga ju atje në bord. Janë dy drejtorët e fondacionit, që i ka vënë fondacioni. Pra, kur të mos jenë më nesër drejtorë, do të vijë drejtori tjetër të jetë atje. Pra, kjo do të thotë që nuk kemi një menaxhim të huaj dhe nuk kemi menaxhim jashtë strukturës.

Parku, natyrisht, ka edhe një arkeolog të përzgjedhur nga ministria, sepse kështu janë të gjitha bordet. Në cilin bord të ngritur Ministria nuk ka të drejtë të caktojë maxhorancën, pra, 3 i cakton firma e ministres dhe 2 drejtorë të fondacionit janë në bord? Kjo duhet sqaruar, sepse u tmerruan njerëzit, të cilët thonë: "Na e morën Butrintin". A është shteti shqiptar i pazoti ta menaxhojë këtë sit?! Po jua them shumë shqip. Cila kompani në botë, më thuaj, profesor i nderuar, miku im shumë i shtrenjtë, nuk i ndan pasuritë e saj dhe i bashkon forcat për t'u bërë më e fortë? Pra, ne, shteti shqiptar, shumë i fortë, me problemet e tij, bashkohet me një partner edhe më të fortë akoma për t'u bërë konkurrent në rajon. Kemi 30 vjet që e bëjmë këtë. Edhe unë jam marrë me kulturë dhe e mbaj mend shumë mirë debatin e Butrintit.

Gjithmonë ka një debat, por nuk ka shanse që të bëhesh i fortë, të bëhesh konkurrent dhe të mos kërkosh të gjes partnerë të fortë. Shumë faleminderit të dyja ministreve që duket sikur po u bëni gjyqin, por po u bëni lapidarë, të cilat kanë krijuar këto mundësi, në mënyrë që të kemi partneritet dhe ky partneritet të jetë konkurrent në rajon! Më vjen mirë që e ngritët këtë debat, në mënyrë që ta bëjmë

diskutimin sa më gjatë të jetë e mundur. Pra, në të gjithë këtë histori më e çuditshmja është se kush do t'i drejtojë zbulimet arkeologjike?! Po i garantojmë shqiptarët, e kemi thënë në çdo moment, edhe ministret e kanë thënë, që asnjë tullë, në fakt, të gjesh një tullë është gjë e madhe, por asnjë qerpiç i gjetur aty nuk do të menaxhohet jashtë rregullave të shtetit shqiptar, që mbron ligji për trashëgiminë kulturore. Për çdo veprim ka një dakordësi të këtij fondacioni me Institutin e Arkeologjisë, që është institucioni shtetëror përgjegjës për të gjithë botën arkeologjike. A janë konsultuar të gjithë?!

Mbi 80 ekspertë kanë qenë në diskutime, por firmën e vë Instituti, i cili thotë se e ka në varësi shteti shqiptar, i drejtuar nga Edi Rama, i cili do të jetë edhe për shumë vite, por kur ta merrni ju, do ta keni ju. Instituti është ai që vë vulën. Këtu kam një shënim, ku thuhet që Parku Kombëtar i Butrintit ka filluar gjërmimet e tij që para 100 e ca vjetësh dhe ai gjërmim është bërë nga zoti Hasan Ceka së bashku me zotin Ugolini. Pra, që kur gjërmimet kanë filluar, nuk ka qenë një vepër 100% shqiptare. Në botën e arkeologjisë, e cila është ndër botët më të bukura, por edhe më konkurrenente, do të ishte mirë që Fondacioni i Butrintit, siç ka pasur gjithë kohën, të ketë disa ekspertë të huaj, të cilët kanë një bashkëpunim të gjatë me shtetin shqiptar.

Kur ka besim më të madh në këtë bashkëpunim të dy partnerëve, do të ketë edhe bashkëpunim më të madh për të ardhur ata që realisht janë arkeologët më të mirë sot në botë. Të gjithë arkeologët e botës, pa dyshim që të gjithë, e kanë ëndërr të gjërmojnë në Butrint. Nuk ka shumë site në zhvillim dhe kjo është një konkurrencë e hapur dhe nuk ka asgjë për të fshehur. Prandaj, se si do të ndodhë kjo pjesë e arkeologjisë, le t'ua lëmë diskutimin ekspertëve. Shumë mirë që u hap ky debat, sepse edhe qytetarët duhet ta kuptojnë se Butrinti nuk do të ketë një ligj të veçantë, por do të jenë ligjet e mbrojtjes të trashëgimisë kulturore ato që do të përcaktojnë marrëdhënien e gjërmimit me zhvillimin e të gjithë sitit të Butrintit.

Kjo është logjika e ndërtimeve në këtë marrëveshje që ka fondacioni me Institutin e Arkeologjisë, ku parashikohet një vlerë mbi 80 mijë dollarë në vit për gjërmime arkeologjike, që, pa dyshim, do të ketë grupe të përbashkëta ekspertësh dhe grupe të përbashkëta arkeologësh. Meqenëse flasim për opozitën, shumë mirë që bëhet opozitë, por si e bëni ju këtë opozitë?! Çfarë do të thotë të bësh opozitë me Butrintin?! Gjeni ndonjë çështje që mund ta mbajë debatin dhe jo këtë, sepse kjo është një nder veprat më të mira që bëhet. Brenda vetes suaj ju e mbështesni zhvillimin që do të ketë Butrinti, por nuk mund të bëhet opozitë me gjënë më të mirë.

Ju mund të gjeni ndonjë gjë që ndoshta ka shkelje, por jo me gjënë që realisht duhet ta shndërrojë jo vetëm Butrintin, jo vetëm Sarandën, jo vetëm Jugun e Shqipërisë, jo vetëm për Shqipërinë, por Ballkanin e Hapur dhe më gjerë në një pikë fokale për zhvillimin e turizmit në Mesdhe. Faleminderit!